



## NJOFTIM PËR SHTYP

**B-COMPETENT. Përmirësimi i Kompetencave të Stafit Penitenciar në Evropë**  
*Ky projekt i ri i BE-së, është i bashkëfinancuar nga Programi për Drejtësinë, i cili do të kontribuojë në mbështetjen e gjerë dhe korrekte të së drejtës së BE-së dhe standardeve lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe nevojave të veçanta të të burgosurve të huaj.*

4 shkurt 2020 – *Garantimi i respektimit të të drejtave themelore të të burgosurve është një parakusht për funksionimin e shtetit të së drejtës. Në institucionet rehabilituese gjithnjë e më multietnike, ku **manaxhimi i diversitetit kulturor** është kthyer në një çështje prioritare, stafi i burgjeve luan një rol thelbësor në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e episodeve të radikalizimit dhe ekstremizmit.*

Vështirësitë e ndeshura nga stafi i burgjeve gjatë trajtimit të të burgosurve të huaj dhe përmbushjes së nevojave të tyre të veçanta, për shkak të **njuhurive të pamjaftueshme** dhe **mungesës së kompetencave**, tregojnë qartë për sfidat në ofrimin e shumë shërbimeve në burgje në sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive dhe në përputhje me standardet dhe të drejtën e BE-së e atë ndërkombëtare, për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve të huaj.

### **B-COMPETENT: misioni dhe objektivat**

Të ndodhur përpara kësaj situatë, projekti “B-ComPetent”, i financuar nga BE, synon të **analizojë mungesat e trajnimeve** në shërbimet e burgjeve duke ofruar një paketë aftësish shumëdisiplinore për stafin civil të burgjeve në 6 shtete (Itali, Francë, Spanjë, Shqipëri, Mal i Zi dhe Greqi). Ky objektivi do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të një **programi inovativ ndërkufitar të trajnimit të trajnerëve**, ndërthurur me shpërndarjen e praktikave më të mira, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmes mjeteve praktike shumëgjuhësore.

Në kuadër të projektit janë parashikuar këto aktivitete: **analizë** e thelluar e **mungesave të trajnimeve** dhe **identifikimi i praktikave më të mira**; krijimi dhe zhvillimi i një **kursi e-learning**; **broshura shumëgjuhëshe** me lojra edukative për stafin civil të burgjeve dhe **video e animuar me skenarë rastesh e çështjesh praktike**; **6 workshop-e ndërkufitare të trajnimit të trajnerëve** në Itali, Shqipëri, Spanjë, Mal të Zi, Greqi dhe Francë; **3 konferenca kombëtare** duke përfshirë grupet kryesore të interesit, si dhe **1 konferencë finale ndërkombëtare**.

Projekti, i cili ka filluar që prej shtatorit të vitit 2019 dhe do të zgjasë 24 muaj, do të zbatohet nga një Konsorcium ndër-sektorial partnerësh nga 3 shtete (Italia, Spanja dhe Shqipëria) përmes organizatave si: Università degli Studi della Campania "Luigi Vanvitelli", (project Coordinator), Observatory of the Penal System and Human Rights (OSPDH-UB), Albanian Ombudsman, Antigone, European Centre Foundation, Prodos Consulting srl and Bosch i Gimpera Foundation.

Bashkëpunimi me autoritetet publike si **Ministria e Drejtësisë Italiane, Shoqata Mesdhetare e Avokatit të Popullit** dhe me organizata të rrjetit evropian si **EUROPRIIS** dhe **EPTA**, do të kontribuojë në ndërtimin efektiv të një praktike komunitare për forcimin e të drejtave të njeriut në burgje.

Për më shumë informacion, vizitoni [www.bcompetent.eu](http://www.bcompetent.eu)

Ndiqui B-ComPetent në rrjetet sociale:



*B-ComPetent është një projekt i bashkëfinancuar nga Programi për Drejtësinë i Bashkimit Evropian, GA nr. 854040. Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Komisionit Evropian.*